

V E N D I M
Nr. 244, datë 30. 12. 2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 21. 11. 2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çëshjen nr. 220 Akti që i përket:

KËRKUES: NEXHAT MALIQATI, përfaqësuar nga avokatët Vasil Plaku e Aqif Peza, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. AGRON CURRI

2. DEGA E BANKËS KOMBËTARE TREGTARE KAVAJË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr. 476, datë 13. 6. 1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. N-25, datë 5.6.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 42/1, 2 të Kushtetutës.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të gjykatave:

- Gjykata e apelit nuk ka zbatuar detyrat e vëna në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;

- Gjykata e apelit pa kërkesën e palëve ka bërë ndryshimin e shkakut ligjor të padisë nga bashkëortakëri në kontratë huaje e shitblerjeje;

- Në kundërshtim me kërkesat e nenit 185 të Kodit Civil, gjykata nuk ka njoftuar me shkrim kërkuesin (i paditur) që ishte në mungesë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesit, subjektin e interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Nexhat Maliqati ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.476, datë 13.6.1999 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr.N-25, datë 5.6.2000 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese, pas gjykimit të çështjes, kaloi në diskutim e votim, por votat u ndanë në mënyrë të tillë që nuk u krijua shumica e kërkuar për marrjen e vendimit.

Përsa më sipër, sipas nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, kërkesa duhet refuzuar.

Refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuesi ta paraqesë përsëri atë në rast se për marrjen e

vendimit krijohen kushte për formimin e shumicës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

- Refuzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.